



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.63/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë**, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit F.B.B.I me NRB..... dhe NRF....., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit NTP “E...” me NRB..... dhe NRF....., me seli në Suharekë, me bazë juridike përmbartimore për pagimin e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe debitorit, të ushtruar kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019 dhe PP.nr.125/2018 i datës 21.03.2019, me datë **25.08.2022**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Aprovohen** si të themelta ankesa e debitorit NTP “E...” me NRB..... dhe NRF....., me seli në Suharekë dhe ankesa e kreditorit F.B.B.I me NRB..... dhe NRF....., me seli në Prishtinë, ndërsa **anulohen** aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PP.nr.125/2018 të datës 19.01.2019 dhe PP.nr.125/2018 i datës 21.03.2019, çështja i kthehet në procedim të serishëm, Gjykatës Komerciale, Dhomës së Shkallës së Parë.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e atakuar nga ana e debitorit, PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019, ka vendosur: “I. Refuzohet prapësimi i debitorit NTP E... me nrb .... dhe nrf ....., me adrese ne fsh, ....., Komuna e Suharekes, ne tërësi si e pabazuar, kështu që: II. Mbetet ne fuqi Urdhri Përmbartimor, P.nr.147/2018, dt.20.11.2018.”

Ndërsa me aktvendimin e atakuar nga ana e kreditorit të të njëjtës gjykatë që mban shenjën PP.nr.125/2018, të datës 21.03.2019, ka vendosur: “I. Shfuqizohet Aktvendimi PP.nr. 125/2018, dt. 11.02.2019, si dhe Anulohen të gjitha pasojat juridike të prodhuara nga çasti i lëshimit të tij. II. Debitorit, N.T.P E..., i mundësohet që të ushtrojë ankesën pa garancion ndaj Aktvendimit Pp.nr. 125/2018, dt. 19.01.2019, të lëshuar nga kjo Gjykatë, e të drejtuar për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë. Pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, aktvendimi i atakuar së bashku me të gjitha shkresat e lëndës i dërgohen Gjykatës së Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.”

Kundër aktvendimit PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019, ne afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të Procedurës Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, të prish aktvendimin e atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës në rigjykim dhe rivendosje.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit.

Kundër aktvendimit PP.nr.125/2018, të datës 21.03.2019, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbaremore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit PP.nr.125/2018, të datës 21.03.2019, të anuloi aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë dhe të mbetet në fuqi aktvendimi PP.nr.125/2018 i datës 19.01.2019 dhe aktvendimi PP.nr.125/2018 i datës 11.02.2019.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktvendimit të ankimuar dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesat e kreditorit dhe debitorit janë të themelta.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori F.B.B.I., me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit NTP "E...", në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës me numër 02a, të datës 22.06.2017, në vlerë prej 22,172.11 Euro, për kryerjen e shërbimeve për shitjen e shtyllave të betonit. Përmbaremore Privat Saranda Rexhepi, me seli në Prishtinë, ka lejuar përmbaremoren me urdhrin P.nr.147/2018, të datës 20.11.2018, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim. Duke vendosur sipas prapësimit gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbaremore. Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit Z.Z. me pretendimin se aktvendimi i atakuar është marr me shkelje dhe se urdhri përmbaremore është lëshuar mbi bazën e një dokumenti të paqëndrueshëm, e të cilin dokument supozohet të këtë lëshuar personi i paautorizuar, e ku ndaj personit të paautorizuar është iniciuar procedura penale dhe është ngritur aktakuzë. Pas pranimit të ankesës, gjykata e shkallës së parë merr aktvendimin e atakuar PP.nr.125/2018 të datës 21.03.2019 me të cilin në pikën I të dispozitivit shfuqizon aktvendimin paraprak të datës 11.02.2019 dhe njëkohësisht anulon të gjithat pasojat juridike të

prodhuara nga çasti i lëshimit të tij, ndërsa në pikën II të dispozitivit i mundëson debitorit që të ushtroj ankesë pa paguar garancion.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar PP.nr.125/2018 i datës 21.03.2019, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas marrjes së vendimit PP.nr.125/2018 të datës 19.01.2019, me të cilën në pikën I ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa në pikën II e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor, ndaj këtij aktvendimi pala e pakënaqur (këtu debitori) ka ushtuar ankesë me të cilën ka njoftuar gjykatën se dokumenti i besueshëm-fatura mbi bazën e se cilës është lëshuar urdhri përmbarimor, rezulton të jetë i falsifikuar e ku ndaj personit përgjegjës është ngritur kallëzim penal, janë filluar hetimet nga ana Prokurorisë në drejtim të dyshuarit për shkak të veprës penale falsifikim dokumenti, e mbi bazën e kësaj gjykata e shkallës së parë ka marr vendimin e atakuar me të cilin ka anuluar të gjitha pasojat e prodhuara nga vendimi i datës 11.02.2019.

Gjykata Komerciale, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se të dyja aktvendimet e atakuar janë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në kuptim të nenit 182 pika (n) duke qenë se aktvendimet e atakuara kanë të meta të tilla të cilat nuk mund të ekzaminohen, ku dispozitivi i aktvendimeve është i pakuptueshëm, ku arsyet janë të paqarta dhe kontradiktore, e po ashtu aktvendimet e atakuar janë marr me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata, në rastin konkret, gabimisht ka vendosur, kur ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit dhe ka shfuqizuar aktvendimin PP.nr.125/2018 të datës 11.02.2019, duke anuluar të gjitha pasojat juridike të prodhuara nga çasti i lëshimit të tij, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka kompetencë që të anuloi vendimet e saja, përkatësisht të vendos sipas ankesës së palës, kjo kompetencë në kuptim të nenit 77 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore i takon gjykatës së shkallës së dyte.

Gjykata e shkallës së dytë konstaton, se gjykata e shkallës së parë po ashtu ka bërë shkelje me rastin e vendosjes sipas aktvendimit PP.nr.125/2018 të datës 19.01.2019, ku ka vendosur që të refuzoi prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.147/2018 të datës 20.11.2018 pasi që nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm – faturën 02a, e bashkëngjitur në propozimin për përmbarim, gjegjësisht vërtetësinë e këtij dokumenti, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se dokumenti i besueshëm fatura 02a e datës 22.06.2017, derivon nga kontrata për shërbime ndërmjetësimi e arritur në mes të marrësit të

shërbimeve (këtu debitori) dhe dhënësit të shërbimeve (këtu kreditori), e ku kontratën në emër të marrësit të shërbimeve e ka nënshkruar I.Z., deri sa nga certifikata e biznesit e lëshuar për kreditorin, rezulton se kreditori është biznes individual i regjistruar me datë 04.11.2009, me pronar Z.Z., i cili rezulton të jetë edhe person i vetëm autorizuar për biznesin e tij, deri sa personi i pretenduar I.Z. nuk rezulton të ketë ndonjë autorizim në këtë biznes, e po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se për shkak të dyshimit të bazuar se me dashje ka kryer vepër penale falsifikim i dokumentit, duke nënshkruar pa autorizim kontratën nga e cila supozohet të derivon fatura ndaj I.Z. është iniciuar procedura penale dhe është ngritur aktakuzë.

Po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se I.Z. ka vdekur e ku si provë është bashkangjitur certifikata e vdekjes nr. ser. ....

Gjykata e shkallës së parë, për shkak të paqartësive lidhur me këtë faturë është dashur që konform nenit 73 të LPP-së, të hap seancë dëgjimore për të kuptuar validitetin e prapësimin dhe kështu të vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Andaj, nga të cekurat më lartë, aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm nëse fatura sipas dispozitave të LPP-së, se a i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.63/2022, me datë 25.08.2022**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami d.v.**